



02 prill 2024

KOMUNIKATË

Seanca e tretë (III) e Bordit të ZRRE në 2024

Ulje e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët fundor për vitin tarifor 2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e tij të tretë (III) për këtë vit, të mbajtur sot, më 02 prill 2024, ka aprovuar tarifatat me pakicë për konsumatorët fundor që furnizohen në kushte të shërbimit universal.

Rënia e çmimeve në tregjet e energjisë elektrike në Evropë ka ndikuar në kostot me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, kostot e furnizimit me energji elektrike nga importi për konsumatorët fundor për vitin 2024 parashihen të jenë më të ulëta në krahasim me vitet e paraprake. Këto ndryshime kanë ndikuar në uljen e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët fundor si vijon:

- Ulje e tarifave prej 8% për konsumatorët familjar për bllokun me konsum mbi 800kWh
- Ulje e tarifave prej 3% për konsumatorët komercial dhe industrial

Bordi i Zyrës së Rregullatorit ka aprovuar edhe tarifatat për vitin relevant tarifor 2024 për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS).

Në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar rezultatet e fituara nga vlerësimi i koncentrimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë përmes indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2023, i cili tregon qartë se kemi të bëjmë me një përqendrim të lartë në tregun e energjisë elektrike, nga ku shihet mungesa e furnizuesve aktiv. Bazuar në rezultatet e këtij raporti, Bordi ka vendosur që Obligimi i Shërbimit Universal për dy vitet e ardhshme t'i ngarkohet KESCO-s.

Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE www.ero-ks.org.

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org